



C.nr.618/14

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtari Ardian Ajvazi, në çështjen juridike-kontestimore të inicuar me padinë e paditesit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna e Ferizajt, menaxhues i KB [REDACTED] [REDACTED] Ferizaj, të cilin e përfaqëson zyrtari i Agjencionit Kosovar të Privatizimit [REDACTED] kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna e Ferizajt, baza e kontestit pagimi i qirasë, me datë 04.10.2016 merrë këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna e Ferizajt, menaxhues i KB [REDACTED] [REDACTED] Ferizaj, të cilin e përfaqëson zyrtari i Agjencionit Kosovar të Privatizimit [REDACTED], e ushtruar kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna e Ferizajt, lidhur me pagimin e qirasë në shumën prej 140.00 Euro.

II. DETYROHET i padituri [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, që paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, menaxhues i KB [REDACTED] [REDACTED] Ferizaj, përkatësisht Agjencionit Kosovar të Privatizimit, t'ia paguan shumën prej 140.00€ (një, katër dhe zero), në emër të pagimit të qirasë për shtatë muaj për periudhën nga muaji tetor 2006 deri në muajin prill të vitit 2007, me kamat ligjore e cila do të llogaritet sipas lartësisë së mjeteve të deponuara që e aplikojne bankat afariste pa destinim të caktuar nga data e ushtrimit të padisë 01.05.2007 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET i padituri [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, që në llogarinë e kësaj Gjykate të paguaj taksën për parashtrimin e padisë në shumën prej 15 Euro si dhe taksën për përpilimin e këtij Aktgjykimi shumën prej 15 Euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të nejt, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësi me datë 01.05.2007 ka parashtruar pranë kësaj Gjykate padi për pagimin e qirasë kundër të paditurit.

Paditësi, përmes përfaqësuesit të AKP-së në padi dhe seancat e mbajtura ka theksuar se palët ndërgjyqjese kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuale duke e nënshkruar kontratën mbi dhënie-marrjen e lokalet afarist me qira me sipërfaqe prej 8 m², i ndërtuar në parcelën kadastrale me numër 948 në fshatin [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, me qiranë mujore prej 20 Euro. I padituri nuk e ka paguar qiranë për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2006 dhe janar, shkurt, mars dhe prill të vitit 2007, që do të thotë shtatë muaj i padituri nuk ka paguar qiranë i propozjës Gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses t'a aprovojë në tërësi si të bazuar në shumën prej 140.00 Euro si dhe shpenzimet e procedurës.

I padituri nuk është përgjigjur në padinë e paditëses si dhe nuk ka prezentuar në seancat e datave 09.08.2016 dhe 04.10.2016, për të cilat është ftuar me rregull, kjo shihet në bazë të fletëkthesave të datave 20.07.2016 dhe 13.08.2016 dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Me propozimin e të autorizuarës së paditëses Gjykata ka mbajtur seancën përgaditore dhe atë kryesore në të njëjtën ditë.

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen e fakteve të çështjes, bazuar në nenin 7.1 lidhur me nenin 319.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provavës dhe atë marrëveshjen komerciale të qirasë të datës 01.06.2016, me anë të së cilës Gjykata e vërtetoi faktin se nënshkrimet palëve ndërgjyqjese ka ekzistuar marrëdhënia kontraktuale për marrje përkatësisht dhënie të lokalit afarist me qira, i cili gjendet në fshatin Daradani në Ferizaj me sipërfaqe prej 8 m², i ndërtuar në parcelën kadastrale me numër 948 n, me qiranë mujore prej 20 Euro. Në këtë kontakt paditësja Bujku ka cilësinë e qiradhënësit, ndërsa i padituri në cilësinë e qiramarrësit. Gjykata pasi, ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e provavës së lartë cekur, në kuptim të nenit 8.1 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv. Gjykata ka çmuar, se kërkesëpdi e paditëses përkitazi me lartësinë e pretenduar ka themelësinë në provën materiale, andaj për këto arsye i padituri është përgjegjës për t'ia paguar paditëses AKP shumën prej 140 Euro.

Palët kontraktuese në marrëdhëniet e detyrimeve duhet të sillen me ndërgjegje dhe mirëbesim, duke respektuar të drejta dhe detyrimet e ndërsjellta, me qëllim që të arrihet edhe synimi i punës juridike dhe përmbushjes së saj në tërësi ashtu siq janë marrë vesh.

Baza juridike

Në nenin 12 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 parasheh "Në themelimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit kanë për detyrë t'i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë", neni 17 "Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij, përgjegjës për përmbushjen e tij. Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve në marrëdhënien e detyrimit ose në bazë të ligjit". Neni 277.1 „Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos kryegjës, edhe kamatin sipas shkallës, e cila në vendin e përmbushjes paguhet në depozimet e kursimit me të parë”, neni 305 „Përmbushja duhet të kryhet kreditorit, ose personit të caktuar



nga ligji nga vendimi gjyqësor, nga kontrata midis kreditorit dhe debitorit, ose nga ana e vet kreditorit. Përmbushja është e plotfuqishme edhe kur i është bërë personit të tretë në qoftë se kreditori e ka akorduar më vonë, apo në qoftë se e ka përdorur atë”.

Gjykata lidhur me shpenzimet ka detyruar të paditurin që të njejtat t'ia kompensoj paditeses, përkatësisht të paguhen në llogarinë e kësaj Gjykate, dhe atë taksën gjyqësore për padi në shumë prej 15 Euro dhe për aktgjykim shumë prej 15 Euro, bazuar në nenin 452.1 të LPK-së dhe Udhëzimit Administrativ nr.2008/2 për unifikimin e taksave gjyqësore të datës 27.11.2008 dhe ndryshuar me vendimet e KGJK-së me numër 20/2012 dhe 37/2012, të aprovuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Andaj nga të cekurat e më lartë e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.618/14, me datë 04.10.2016

Gjyqtari,
Ardian Ajvazi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njetit, në Gjykten e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kesaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KO

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC,



M. 14.10.16